



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:178982

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06583370

ARJ nr.251/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Milena Djerić dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike sipas padisë në konfliktin administrativ të propozuesit-paditësit “A...,” shpk me NUI me seli në F.K., të përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” shpk në Prishtinë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), me seli në Prishtinë dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar (SHSKUK), me seli në P., me bazë juridike anulim i vendimit të paditurit OSHP nr.2024/0388 të datës 12.06.2024, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të propozuesit-paditësit, parashtruar përmes të autorizuarit të tij, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1484/24 të datës 28.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 10 Dhjetor 2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga propozuesi-paditësi, “A...”, sh.p.k., me NUI me seli në F.K., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1484/24 të datës 28.08.2024.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1484/24 të datës 28.08.2024, **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit A..., sh.p.k., me NUI me seli në F. K., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.307/24 i datës 01.07.2024, **VËRTETOHET**.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të dhomës së shkallës së dytë, të Gjykatës Komerciale, propozuesi-paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit e paditësit “A”, sh.p.k., e parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomave të Shkallës së Dytë, me numër K.Dh.Sh.II.nr.1484/24 të datës 28.08.2024. NDRYSHOHEN në tërësi aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomave të Shkallës së Parë -Departamentit për Çështje Administrative, me numër KA.nr. 307/2024 të datës 01.07.2024 dhe aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomave të Shkallës së Dytë, me numër K.Dh.Sh.II.nr.1484/24 të datës 28.08.2024, ashtu që APROVOHET në tërësi si i bazuar propozimi i paditësit “A”, sh.p.k., për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ-vendimit të paditurit Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik me numër OSHP:/... të datës 12.06.2024. SHTYHET ekzekutimi i vendimit të të paditurit Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik me numër OSHP: 2024/0388 i datës 12.06.2024, deri në vendosjen përfundimtare sipas kërkesëpadisë me aktgjykim meritor, ose të APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit e paditësit “A....” sh.p.k., e parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomave të Shkalles së Dyte, me numër K.Dh.Sh.II.nr.1484/24 të datës 28.08.2024. ANULOHEN në tërësi aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomave të Shkallës se Dytë, me numër K.Dh.Sh.II.nr.1484/24 të datës 28.08.2024 dhe aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomave të Shkallës së Parë-Departamentit për Çështje Administrative, me numër KA.nr.307/2024 e datës 01.07.2024 dhe lënda i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të Dhomës së shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurit OSHP nr.2024/0388 të datës 12.06.2024, APROVOHET si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “A.....” shpk, me nr.2024/0388, e datës 03.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material medicinal nga LE për nevojat e SHSKUK-së”, me numër të prokurimit, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – SHSKUK-Shërbimi Klinik Universitar i Kosovës dhe MBETET NË FUQI njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material medicinal nga LE për nevojat e SHSKUK-së”, me numër të prokurimit iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)- “SHSKUK-Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës”. AK mund të vazhdoj tutje me procedurën e prokurimit.

Kundër këtij vendimi propozuesi-paditësi, ka parashtruar padi me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative K.A.nr.307/24 i datës 01.07.2024, Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit "A", ShPK me NUI, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit OSHP:2024/0388 të datës 12.06.2024 të së paditurit të parë Organi Shqyrtues i Prokurimit, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me padinë e paditësit.

Në arsyetim të aktvendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet nga neni 22 par. 2 lidhur me par. 6 të LKA-së për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ. Paditësi nuk e ka provuar se do t'i shkaktohej dëm vështirë i riparueshëm nëse ekzekutohet vendimi i goditur, si kusht i parë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ. Paditësi nuk ka paraqitur asnjë pretendim relevant se atij do t'i shkaktohej dëm vështirë i riparueshëm, nëse ekzekutohet vendimi i goditur ose kontrata e cekur më lartë. Ai në tërë kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ thirret në kundërligjshmërinë e aktit administrativ, gjë që gjykata nuk mundet ta vlerësoj në këtë fazë të procedurës, meqenëse ajo është çështje meritore për të cilën gjykata vendos pas shqyrtimit të tërësishëm të çështjes. Në anën tjetër, paditësi nuk ka sqaruar se cili dëm konkretisht i shkaktohet me ekzekutimin e vendimit të goditur, pse ai dëm është vështirë i riparueshëm, dhe si shtyrja e ekzekutimit të vendimit të goditur e parandalon shkaktimin e atij dëmi.

Në vazhdim ka theksuar se, pretendimi i paditësit se me ekzekutimin e vendimit të goditur do të dëmtohej buxheti i Republikës së Kosovës nuk paraqet pretendim që lidhet me dëmin eventual vështirë të riparueshëm që i shkaktohet atij (paditësit), por autoriteteve publike. Siç është sqaruar në pjesën e kritereve dhe autorizimeve të gjykatës për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, rreziku për dëmin vështirë të riparueshëm duhet të ekzistoj vetë në raport me paditësit si parashtrues i kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, por jo në raport me ndonjë palë tjetër, aq më pak në raport me autoritetet publike. Kjo nënkupton se, ligjdhënësi nuk i ka dhënë autorizim gjykatës që për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të vlerësoj edhe dëmin eventual që i kanoset shtetit ose autoritetit publik me ekzekutimin e aktit administrativ, rrjedhimisht gjykata faktet e kësaj natyre nuk mund t'i marrë për bazë, pavarësisht se mund të jenë të qarta. Për këtë arsye, gjykata këtë pretendim e gjen si të pabazuar në kuptim të LKA-së. Paditësi nuk ka ngritur pretendime për shkaktimin e ndonjë forme tjetër të dëmit, i cili vështirë do të riparohej, si dhe nuk ka paraqitur prova, nga e cila do të bëhej e besueshme se do t'i shkaktohej ndonjë dëm tjetër i vështirë i riparueshëm, krahas formave të dëmit të trajtuara më lartë. Gjithashtu, gjykata vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ të goditur do të ishte në kundërshtim me interesin publik (kushti i dytë). Gjykata sqaron se procedura në bazë të cilës është nxjerr akti administrativ i goditur është procedurë ligjore, rrjedhimisht ai prodhon efekte juridike, si rezultat i kësaj ai zbatohet sipas rrjedhës normale të procedurës administrative, deri sa ekzekutimi i tij nuk ndalohet nga gjykata ose vet organi administrativ. Duke u nisur nga kjo dhe nga fakti se nxjerrjes së çdo aktit administrativ i paraprinë një interes publik, atëherë i bie që interesi publik për ekzekutimin e aktit administrativ supozohet, ndërsa është obligim i paditësit si parashtrues i kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ që të provoj se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me atë interes. Pra, përputhshmëria e shtyrjes së

ekzekutimit të aktit administrativ me interesin publik nuk mund të merret si e mirëqenë, por duhet të argumentohet duke ngritur pretendime faktike dhe juridike, si dhe të provohet me prova.

Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë vlerëson se, paditësi nuk ka ngritur asnjë pretendim valid, por thjeshtë në mënyrë të përgjithshme ka deklaruar se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, e aq më pak ka paraqitur prova që e provojnë faktin se me shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të goditur nuk cenohet interesi publik. Në lidhje me kriterin e tretë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, gjykata vlerëson se edhe nëse nga shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ nuk do t'i shkactohej dëm të Paditurit, megjithatë kjo nuk është më relevante, përderisa kushtet tjera nuk janë plotësuar. Andaj, në kuptim të nenit 13 par.1 nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, si dhe nenit 22 par. 7 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të saj.

Dhomat e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale në procedurë ankimore me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur si në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenit 49 të LKA-së të LPK-së, e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërteton. Në arsyetim pasi bënë përshkrimin e gjendjes së vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të saj, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit në rastin konkret nga paditësi nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së. Pretendimet e paditësit në ankesë i refuzon si jo të qëndrueshme, të pa mjaftueshme, dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa, nga se edhe sipas kolegjit kërkesa tërësisht mbështet në fakte që kanë të bëjnë me çështjen kryesore për të cilën gjykata do të vendos në mënyrë meritore në procedurë të rregullt, por që tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesë për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Andaj konstaton se dhoma e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozita procedurale dhe materiale me refuzimin e propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimin të pretendimeve në kërkesë, ekzaminimit të aktvendimit të kontestuar të Dhomës së Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës vlerëson se, dhoma e shkallës së dytë ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së propozuesit-paditësit dhe vërtetimin e aktvendimit të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së dytë por edhe të Shkallës së parë në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktvendimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të esenciale të dispozitave të procedurës nga neni 22 të LKA-së, dhe dispozitave të LPK-së, e po ashtu nuk është bërë zbatim i gabuar i të drejtës materiale ashtu si pretendohet nga paditësi në kërkesë. Aktvendimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare dhe konkrete të vërtetuara sipas së cilave ka rezultuar se kërkesa e propozuesit-paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur është e pa bazuar.

Sipas nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se, me kërkesën e paditësit akti i organit i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22 paragraf 6 të njëjtit ligj, përcaktohet se paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi nuk ka arritur të dëshmojë me prova bindëse mbështetjen e kërkesës së tij, se me ekzekutimin e vendimit të organit administrativ do ti shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej, që shtyrja-pezullimi i ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk është në kundërshtim me interesin publik, dhe shtyrja nuk do ti shkaktonte dëm të pa riparueshëm apo të madh palës kundërshtare, përkatësisht palës së interesuar. Pra, në çështjen juridike konkrete edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, nga propozuesi-paditësi nuk janë plotësuar kushtet ligjore siç parashihen në nenin 22, të LKA-së në mënyrë kumulative të cilat janë të domosdoshme që pastaj gjykata të nxjerrë vendim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ të paditur deri në vendosjen meritore të çështjes sipas padisë me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Nga kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjykata nuk ka mundur të identifikoj pretendimet e propozuesit-paditësit lidhur me dëmin e riparueshëm i cili mund të i shkaktohet me ekzekutimin e vendimit kontestues. Përgjatë gjithë elaborimit të kërkesës, propozuesi-paditësi më shumë i referohet procedurës së prokurimit, të zhvilluar pranë autoritetit kontraktues lidhur me kriteret e ofertimit sesa argumentimi i dëmit real dhe konkret të cilin mund ta pësoj propozuesi-paditësi me rastin e ekzekutimit të vendimit kontestues.

Pretendimet në kërkesë lidhur me interesin publik, dhe dëmin e mundshëm për palën e interesuar, ku ndër të tjera theksohet se: do të dëmtohet buxheti i Republikës së Kosovës ngase oferta e operatorëve ekonomik fitues për lot 1, 2 dhe 3 është më e shtrenjtë rreth dy milion euro, sesa e propozuesit-paditësit dhe kjo dëshmohet me anë të provës procesverbali i hapjes së ofertave të datës 23.04.2024, kolegji i Gjykatës Supreme i vlerëson si të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Këto pretendime janë të mbështetura kryesisht në fakte që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, kontestimin e ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur Organit Shqyrtues të Prokurimit, por që ligjshmëria e tij nuk shqyrtohet në këtë fazë të vendosjes për masë të përkohshme, por në procedurë të rregullt gjatë vendosjes meritore të çështjes pas shqyrtimit të provave dhe fakteve sipas padisë së tij.

Aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë, nuk rezulton se është i përfshirë as me shkelje procedurale të dispozitave nga neni 182 par. 1 dhe 2, pika (n) dhe 160 par.4 të LPK-së. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktvendimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye lidhur

me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, gjykata vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen për kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Prandaj pretendimet e propozuesit-paditësit në kërkesë nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje, nga ajo e vendosur si në aktvendimet e Gjykatës Komerciale të shkallës së parë dhe dytë, të cilët janë të drejtë ligjor dhe të arsyetuar mjaftueshëm bazuar në faktet vendimtare për aq sa është e domosdoshme të arsyetohet mënyra e vendosjes për masë të përkohshme, sipas provave dhe fakteve të paraqitura nga propozuesi-paditësi, ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së, dhe pa u prejudikuar vendosja e çështjes kryesore.

Nga theksimet si më lartë e në bazë të nenit 54, par.1, lidhur me nenin 22, par.2 dhe 6, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ nr.251/2024, me datë 10 Dhjetor 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani